



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga

Vlora Spanca,

Auditore e Përgjithshme

**Prishtinë, qershor 2024**

## PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

**Baza për konkluzion**

- B1 ATK në 85 raste kishte vonesa në trajtimin e kërkesave të tatim paguesve për kthim /rimbursim tatimor mbrenda afatit ligjor;
- B2 Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale; dhe
- C1 Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

**Çështje tjetër**

- 1 Në kuadër të raportit të auditimit për Ministrinë e Financave, Punës dhe Tranfereve, janë të përfshira edhe Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës, derisa Pasqyrat Vjetore Financiare të tyre për vitet paraprake janë audituar dhe raportuar si të ndara.

**Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

**Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat ishin efektive, me perjashtim të vonesave në shqyrtimin e kerkesave të tatimpaguesve për kthim/rimbursim tatimor. Ndërsa kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar parregullsitë.

Mangësitë kryesisht janë vërejtur në avanset e pambyllura nga vitet paraprake dhe klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve.

Këtë vit kishte një rënie të gabimit financiar për pagesat e pensioneve për personat e punësuar ndërsa për pensionet e paguara pas vdekjes dhe perfituesit e më shumë se një pensioni nga skemat pensionale kishte rritje në krahasim me vitin paraprak, prandaj ende mbetet sfida menaxhimi i tyre.

Menaxhimi i pasurisë mbetet ende sfida për tu adresuar plotësisht pasi që nuk është kryer në plotëni inventarizimi i pasurisë në të gjitha agjencitë e Ministrisë. Po ashtu, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet kontigjente nuk ishin prezantuar drejtë pasi regjistrat ishin jo të saktë dhe jo të plotë.

Ky raport ka rezultuar me nëntë rekomandime, prej tyre një është rekomandim i ri, pesë të përsëritura dhe tre pjesërisht të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

## 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B1 - Vonesë në shqyrtimin e kërkesave për kthim/rimbursim tatimor nga ATK

#### Gjetja

Neni 30 i ligjit për Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) dhe Procedurat, obligon ATK-në që brenda 60 ditëve të shqyrtoj dhe aprovoj kërkesën nga tatim paguesit për kthim/rimbursim tatimor. Nëse kërkesa për kthim/rimbursim është aprovuar nga ATK mirëpo është tejkaluar afati ligjor, atëherë duhet të paguhet edhe interes tatim paguesve për vonesa.

Nga testimet dhe analiza e bazës së kthimeve/rimbursimeve, identifikuam 85 raste ku ATK nuk i kishte shqyrtuar kërkesat e tatim paguesve për kthim/rimbursim tatimor brenda afatit ligjor. Këto vonesa ishin nga 2 deri në 344 ditë kalendarike përtej afatit ligjor. Për këto vonesa, ATK nuk kishte aplikuar pagesën e interesit ndaj tatim paguesve.

Menaxhimi nga ATK për këtë çështje nuk ka qenë efektiv, ndonëse ATK pohon se ka mungesë të kapaciteteve në staf, megjithatë, nuk është vërejtur se ka pasur ndonjë veprim konkret rreth kësaj çështje përkundër faktit që kjo çështje është përsëritur.

#### Ndikimi

Vonesat në kthime/rimbursime tatimore, ju shkaktojnë bizneseve vështirësi financiare në ushtrimin e aktiviteteve të tyre operative dhe në anën tjetër rrisin rrezikun e padive të tatim paguesve ndaj ATK-së si pasojë e mos pagesës së interesit.

#### Rekomandimi B1

Ministri duhet të sigurojë përmes drejtorit të ATK-së menaxhim efikas në procesin e shqyrtimit të kërkesave për kthime/rimbursime, në mënyrë që të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar ligjor. Po ashtu, të analizoj shkaqet që kanë shkaktuar ngecjen, përfshirë kapacitetet aktuale, dhe të shtojë fokusin në trajtimin e kërkesave, kjo edhe për faktin që me ligjin e ri të ATK-së afati për shqyrtim është ulur në 30 ditë dhe çdo vonesë do të ketë kosto më të lartë të interesit në rastet e rimbursimeve.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## Çështja B2 - Përfitimi i më shumë se një pensioni nga skemat pensionale

### Gjetja

Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, rregullon pensionet bazë të moshës, pensionet kontribut pagues të moshës, pensionet e aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionet familjare dhe pensionet invalidore të punës. Sipas nenit 16 të këtij ligji, personat të cilët janë përfitues të cilët do pension të skemave të përcaktuara me këtë ligj në asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni tjetër nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen nga shteti.

Sipas ligjit Nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L054 për Statusin dhe të drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre - neni 5.1.4 përfituesit e pensioneve familjare, invalidor personal dhe invalidor familjar nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është e përcaktuar me ligj.

Sipas ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së neni 16 pika 2, Veteranët e UÇK-së nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse veterani është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti duhet të përcaktohet se cilin pension do ta marrë.

Sipas ligjit Nr. 04/L-084 për pensionet e Pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, neni 5.3 përfituesit që kanë të drejtë në pensionin e FSK-së duhet të zgjedhin njërin nga përfitimet: pensionin që u takon me këtë ligj, apo përfitimet tjera që parashihen me ligjet tjera në fuqi.

Për këtë qëllim është e rëndësishme të theksohet se Ligji nr.03/L-100 për Pensionet e pjesëtarëve të TMK-së nuk ka ndonjë dispozitë ligjore e cila në mënyrë të qartë ua njeh të drejtën e vazhdimit të marrjes së pensionit të TMK-së nëse personat e njejtë gëzojnë edhe ndonjë pension tjetër nga skema pensionale.

Bazuar në krahasimin e të dhënave të Ministrisë për skemat pensionale dhe sociale kemi identifikuar se Ministria kishte kryer pagesa në vlerë 1,436,201€ për përfitues të cilët gëzojnë më shumë se një pension. Rastet më të shpeshta të përfitimit të më shumë se një pensioni nga skemat pensionale, janë përfituesit që i takojnë kategorisë së TMK-së dhe FSK-së, të cilat pagesa Ministria i kishte kryer edhe vitin e kaluar bazuar në vendimin e ish Kryeministrit nr. 12/82 të datës 28.12.2018. Me këtë vendim ishte aprovuar vazhdimi i pagesave të pensioneve të dyfishta për FSK dhe ish-pjesëtarët e TMK-së deri në interpretimin përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale.

**Tabela 1. Përfituesit e më shumë se një pensioni nga skemat pensionale**

<b>Nr</b>	<b>Lloji i Skemës</b>	<b>Numri i pagesave</b>	<b>Gabimi Financiar (EUR)</b>
1	Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës FSK dhe DFDIL Familjar	1,634	412,672
2	Pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës FSK dhe DFDIL Veteran	-	-
3	Pensionet e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës TMK dhe DFDIL Familjar	4,751	1,007,217
4	Pensionet e Trupave të Mbrojtjes së Kosovës TMK dhe DFDIL Veteran	12	1,975
5	Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL Familjar	-	-
6	Pensionet Bazë (PB) dhe DFDIL Veteran	-	-
7	Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL Familjar	70	13,997
8	Pensionet Kontributive (PK) dhe DFDIL Veteran	1	170
9	Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK) dhe DFDIL Familjar	-	-
10	Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK) dhe DFDIL Veteran	1	170
11	DFDIL Familjar PIP	-	-
12	Trepça dhe DFDIL Vetran	-	-
13	KV dhe DFDIL Familjar	-	-
<b>Gjithsej</b>		<b>6,469</b>	<b>1,436,201</b>

Shkak për këtë gjendje ishte mungesa e interpretimit përfundimtar të ligjeve për skemat pensionale.

**Ndikimi**

Pagesat e pensioneve të dyfishta për personat e njëjtë pa një interpretim të bazës ligjore nga organet përgjegjëse mund të dëmtojnë buxhetin e Ministrisë.

**Rekomandimi B2**

Ministri duhet të inicojë procedurat për të bërë interpretim dhe vlerësim të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore në lidhje me pensionet e dyfishta.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## **Çështja C1 - Përfituesit e pensioneve dhe ndihmave sociale nga personat e punësuar dhe pensionet e paguara pas vdekjes**

### **Gjetja**

Sipas nenit 10.4.2 të ligjit Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga Shteti, pensionet e parakohshme "Trepça" ndërpriten së paguari, nëse personi punësohet apo vetëpunësohet. Më tutje, sipas nenit 16.4 të ligjit Nr.04/L-261 për Veteranët e UÇK-së - Veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit, si dhe sipas nenit 4.4 të ligjit Nr.04/L-096 për skemën e ndihmës sociale ndalon të drejtën për ndihmë sociale për persona të punësuar.

- a) **Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar** - Nga krahasimi i të dhënave të MFPT-së për skemat pensionale dhe ndihmat sociale me të dhënat e ATK-së, kemi vërejtur se ekzistojnë raste të përfitimit të pensioneve apo ndihmave sociale nga persona të cilët punojnë apo realizojnë të ardhura personale. Vlera e gabimit financiar për vitin 2023 ishte 134,110€. Krahasuar me vitin e kaluar vlera e gabimit ka rënie për 140,270€.

Tabela 2. Përfitimet e pensioneve nga personat e punësuar

Nr	Lloji i Skemës	Numri i pagesave	Gabimi Financiar (EUR)
1	Ndihma Sociale	148	17,400
2	Pensionet Trepça	25	3,150
3	DFDIL Veteran	686	113,560
<b>Gjithsej</b>		<b>859</b>	<b>134,110</b>

Sipas Ligjeve përkatëse të skemave pensionale dhe rregullave të aplikueshme, pensionet duhet të ndalen pas vdekjes së përfituesve.

**b) Pensionet e paguara pas vdekjes** - Nga krahasimi i të dhënave/regjistrave ndërmjet MFPT dhe Agjencisë së Regjistrimit Civil kemi gjetur se gjatë vitit 2023 janë realizuar gjithsej 920 pagesa, në vlerë totale 118,316€ për pensione pas vdekjes së përfituesve.

Tabela 3. Pensionet e paguara pas vdekjes

Lloji i pensionit (Skemës Pensionale)	Pagesat për përfituesit që kanë vdekur para vitit 2023		Pagesat për përfituesit që kanë vdekur gjatë vitit 2023		Gjithsej pagesat pas vdekjes së përfituesve	
	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)	Numri i pagesave	Shuma (€)
Skema e të verbërve	12	3,000	10	2,250	22	5,250
Pensionet Bazë	78	8,400	479	50,100	557	58,500
Pensionet Kontributive	13	2,774	137	27,711	150	30,485
Pensionet për Persona me Aftësi të Kufizuar (PPAK)	32	3,200	47	4,800	79	8,000
Pensionet e Parakohshme të Trepçës	-	-	1	126	1	126
Arsimi	33	2,710	27	2,324	60	5,034
Pensionet e TMK-se	-	-	1	181	1	181
DFDIL Veteran	4	680	23	3,910	27	4,590
Pensionet për Paraplegjiket dhe Tetraplegjiket (PPTP)	12	1,800	11	4,350	23	6,150
<b>Gjithsej</b>	<b>184</b>	<b>22,564</b>	<b>736</b>	<b>95,752</b>	<b>920</b>	<b>118,316</b>

Pagesat pas vdekjes së përfituesve, ndodhin kryesisht si rezultat i lajmërimit me vonesë apo edhe kur vdekjet e përfituesve nuk ishin regjistruar me kohë në ARC, dhe ministria nuk kishte informata për rastet.

**Ndikimi**

Përfitimi i pensioneve nga personat e punësuar dhe mbetja e personave të vdekur në listat e pagesave shkaktojnë pagesa të parregullta, duke dëmtuar kështu buxhetin e Ministrisë.

**Rekomandimi C1**

Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër dhe të shqyrtoj mundësitë për kthimin e tyre nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet databazave të skemave pensionale.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.2.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2023 ishte 16,083,300€, prej tyre ishin shpenzuar 9,454,301€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me tiketa siguruese (banderolat), blloibat, karburant për vetura, sigurimi i ndërtesave tjera, qiraja për ndërtesa, mirëmbajtja e teknologjisë informative etj.

#### Çështja C2 - Avanset e pambyllura në SIMFK nga vitet paraprake

**Gjetja** Sipas Rregullores 06/2023 për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqesimit, neni 8, avanset për udhëtime zyrtare duhet të mbyllen brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Avanset e pambyllura deri në fund të vitit 2023 në MFPT ishin 32,926€. Ato kanë të bëjnë me avanse të bartura nga vitet paraprake të ish Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të cilat kryesisht ishin mjete të tërhequra nga kredit kartelat nga stafi politik, të cilat nuk ishin arsyetuar dhe kthyer nga zyrtarët përkatës. Pas veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti i MFPT-së në vitin 2023 ka një ulje (mbyllje të avanseve) prej 30,241€, krahasuar me vitin paraprak.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përgjegjësisë së personelit që i ka marrë këto mjete duke mos ofruar dëshmi për arsyetimin e tyre apo kthimin e tyre, edhe pse ministria i ka njoftuar për obligimet e pambyllura të tyre.

**Ndikimi** Mos arsyetimi dhe mos kthimi i mjeteve nga zyrtarët që i kanë shpenzuar, kanë dëmtuar buxhetin e ministrisë, dhe kanë ndikuar në mos barazimin e llogarive të avanseve për vite me radhë.

**Rekomandimi C2** Ministri përmes Sekretarit të Përgjithshëm, duhet të siguroj vazhdimin e marrjes së veprimeve ligjore (përmbartimore) ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar - avanset.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.2 Çështjet e përbashkëta për kategori të caktuara ekonomike

### Çështja B3 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

#### Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 - Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël kërkon nga ZKA dhe ZKF të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Gjatë vitit 2023 ishin paguar dhe regjistruar shpenzimet në kategori ekonomike joadekuate në vlerë prej 461,560€ si në vijim.

- Shpenzimet me vendime gjyqësore nga MFPT në vlerë prej 21,592€ për pensione bazike, pensione të aftësisë së kufizuar etj. ishin paguar nga kategoria mallra dhe shërbime edhe pse për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve;
- Shpenzimet nga ATK për blerje të pajisjeve (mbi 1,000€) dhe licencave tri vjeçare në vlerë prej 347,734€ ishin paguar nga kategoria mallra dhe shërbime e që për nga natyra dhe vlera i takojnë kategorisë së investime kapitale;
- Shpenzimet me vendime gjyqësore nga ATK në vlerë prej 5,454€ për pension invalidor ishin paguar nga kategoria mallra dhe shërbime edhe pse për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së subvencioneve dhe transfereve; dhe
- Shpenzimet për mirëmbajtje dhe liceca një vjeçare nga Dogana e Kosovës në vlerë prej 86,780€ ishin paguar nga kategoria e investimeve kapitale e që për nga natyra i takojnë kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos planifikimit të duhur në kategori përkatëse gjatë ndarjes së mjeteve financiare me Ligj të Buxhetit dhe mungesës së kontrolleve.

#### Ndikimi

Raportimi apo klasifikimi jo i saktë i të dhënave në pasqyrat financiare shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të Ministrisë, duke mbivlerësuar /nënvlerësuar kategoritë ekonomike përkatëse.

#### Rekomandimi B3

Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. Po ashtu, pagesat me vendime gjyqësore duhet të realizohen nga kategoria adekuate e shpenzimit.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 2.2.3 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 24,059,075€, pasurive jokatitale është 792,488€, si dhe e stokeve 552,649€.

#### Çështja B4 - Mos kryerja e procesit të inventarizimit të pasurisë

**Gjetja** Sipas Rregullores nr.02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore, neni 19, thekson se raporti i inventarizimit duhet të përgatitet para përgatitjes së PFV-ve në mënyrë që komisioni i inventarizimit të ketë mundësinë e krahasimit të gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Ne identifikua se:

- Agjencia e Punësimit nuk ka formuar komision dhe nuk e ka kryer fare inventarizimin e pasurisë për vitin 2023; dhe
- Inspektoriati i Punës ka përfunduar inventarizimin me një vonesë prej 20 ditëve pas përgatitjes së PFV-ve të Ministrisë.

Shkak i këtyre mangësive ishte kujdesi jo i duhur dhe kontrollet jo efektive të menaxhmentit të agjencive përkatëse në lidhje me procesin e inventarizimit.

**Ndikimi** Mos kryerja e inventarizimit të pasurisë dhe mos harmonizimi i regjistrave të pasurisë, ndikon në mos verifikimin e saktësisë, cilësisë dhe gjendjes fizike të pasurive të Ministrisë. Po ashtu, kjo rritë rrezikun që ndryshimet eventuale të konstatuara nga procesi i inventarizimit të mos reflektohen në regjistrat e pasurive të prezantuara në Pasqyra Financiare.

**Rekomandimi B4** Ministri, duhet të siguroj përmes drejtorëve të agjencive përkatëse që para përgatitjes së pasqyrave financiare të MFPT-së të bëhet inventarizimi i plotë i pasurisë si dhe krahasimi i gjendjes së inventarizuar me regjistrat e pasurive në mënyrë që të bëhen korrigjimet e nevojshme për një prezantim të saktë dhe të plotë të pasurive në PFV.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.2.4 Të arkëtueshmet

MFPT kishte shpalosur në PFV, llogari të arkëtueshme vlerën prej 585,333,167€, apo për 60,025,655€ më shumë se vitin paraprak. Kjo vlerë përbëhet prej ATK-së 534,214,817€, Doganës 50,046,199€, dhe Inspektoriatit i Punes 1,072,151€.

### Çështja C3 - Menaxhimi i llogarive të arkëtueshme/ borxheve të vjetra

**Gjetja** ATK për vitin 2023 në planin e punës të rishikuar kishte përcaktuar që të inkasohen borxhet në vlerë 212,756,609€. Po ashtu, në planin punës ishte paraparë ndërmarrja e iniciativave për të pastruar stokun e borxhit nga të gjitha borxhet e pa mbledhshme.

ATK kishte bërë progres në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme (borxheve të reja). Në vitin 2023 ishin mbledhur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 193,848,973€ apo 91% nga ajo që ishte planifikuar me rishikim të planit për vitin 2023. Për nga vlera e mbledhur kishte një rritje prej 25% krahasuar me vitin paraprak pasi që në vitin 2022 ishin mbledhur 155,273,103€.

Megjithatë, gjatë vitit 2023 ATK nuk ka treguar efikasitet në mbledhjen e borxheve të vjetra (borxhet e pa mbledhshme), vlera e tyre në fund të vitit 2023 kishte arritur në 136,462,995€, krahasuar me vitin 2022 që ishte 115,472,121€. Rritja vjen nga aplikimi i ndëshkimeve dhe interesit që aplikohen në sistem.

Rritja e stokut të borxhit të vjetër është një sfidë e vazhdueshme e cila është kryesisht e ndikuar nga pushimi i aktivitetit të operimit të bizneseve.

**Ndikimi** Niveli i ulët i arkëtimit të borxheve të vjetra rritë stokun e borxheve të akumuluar, të cilat me kalimin e kohës shndërrohen në borxhe të pambledhshme.

**Rekomandimi C3** Ministri përmes Drejtorit të ATK-së duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut të borxheve të vjetra, apo të ndërmirren veprime konkrete që kjo çështje të rregullohet me bazë ligjore përkatëse.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### **Çështja A1 - Nënvlërsim i llogarive të arkëtueshme në PFV**

**Gjetja** Regjistri i llogarive të arkëtueshme ishte nënvlërsuar për 225,281€, për faktin që të arkëtueshmet nga Njësia e Intelegjencës Financiare (NjIF) nuk ishin përfshirë në PFV-të e Ministrisë.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos raportimit të llogarive të arkëtueshme nga NjIF.

**Ndikimi** Mos raportimi i saktë i llogarive të arkëtueshme ka ndikuar në nënvlërsimin e tyre në PFV.

**Rekomandimi A1** Ministri, duhet të siguroj koordinim në mes të njësive në kuadër të ministrisë me qëllim që regjistrat e llogarive të arkëtueshme të mbahen të saktë dhe të azhurnuar, në mënyrë që me rastin e konsolidimit të PVF-ve shënimet të prezantohen saktë.

### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2.5 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2023, ishte 1,332,270€. Kjo vlerë përbëhet prej Doganës së Kosovës 742,250€ dhe Administratës së MFPT 592,908€. Në PFV janë shpalosur edhe paditë e ushtruara ndaj ATK-së për të cilat nuk është cekur vlera e përafert financiare.

### Çështja B5 - Mangësi në prezantimin e detyrimeve kontigjente

**Gjetja** Bazuar ne Rregulloren MF nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore (OB), OB-të mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jofinanciare. Sipas nenit 18 të kesaj rregullore OB duhet të raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Ne identifikuar se:

- Dogana në PFV-të e saj kishte bërë shpalosjen e listës së detyrimeve kontigjente por që kjo listë nuk i përfshinte të gjitha paditë që janë në procedurë ndaj Doganës. Tre (3) lëndë në vlerë 1,595,079€ nuk ishin raportuar si detyrime kontingjente duke bërë nënvlerësimin e tyre në PFV;
- ATK në PFV-të e saj kishte bërë shpalosjen e listës së padive që kishin të bënin me kontestet e tatim paguesve, sipas shënimeve të marra nga gjykata themelore, duke prezantuar pa vlerë financiare. Po ashtu, ATK edhe paditë për kompensim të shujtave ditore dhe pagave jubilarë të bëra nga stafi i ATK-së, i kishte prezantuar pa vlerë financiare; dhe
- Regjistri i detyrimeve kontigjente tek administrata e MFPT ishte mbivlerësuar për 14,830€ pasi që lënda që ishte paguar nga MFPT nuk ishte larguar nga lista e detyrimeve kontigjente.

ATK-ja paditë e tatim paguesve nuk i ka prezantuar me vlerë, pasi ato ishin të pabazuara dhe ishte vlerësuar se gjasat që ATK të ketë dalje të parasë janë shumë të ulëta. Kjo sepse ATK i ka shqyrtuar në disa nivele ankesat e tatim paguesve (shpalosja e listës ishte bërë për qëllime të transparencës). Përderisa te paditë e ushtruara nga stafi në lidhje me shujtat, ATK nuk kishte bërë ndonjë vlerësim.

**Ndikimi** Prezentimi jo i plotë i detyrimeve kontingjente ndikon që PFV-të të mos prezantojnë gjendjen e duhur dhe vlera e tyre financiare të nënvlerësohet, përderisa mos azhurnimi i regjistrit të detyrimeve kontingjente nga lëndët e paguara ndikon që vlera e tyre financiare të mbivlerësohet.

**Rekomandimi B5** Ministri, përmes drejtuesve të agjencive duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 4. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>1,111,170,611</b>	<b>936,037,857</b>	<b>823,917,867</b>	<b>752,789,075</b>	<b>655,901,138</b>
Grante Qeveritare – Buxheti	1,035,751,611	848,557,990	789,689,804	752,437,041	654,946,981
Financimi përmes huamarrjes	19,619,000	27,855,085	6,553,522	253,858	743,969
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	55,800,000	54,420,628	22,631,590	0	0
Fondi zhvillimor në mirëbesim	0	4,773,878	4,773,878	0	0
Donacionet vendore	0	131,712	114,750	0	0
Donacionet e jashtme	0	298,564	154,323	98,176	210,188

Buxheti final është më i ulët se buxheti fillestar për 175,132,754€. Kjo zbritje është rezultat i zvogëlimit të buxhetit përmes grantit qeveritar.

Në vitin 2023 MFPT ka shpenzuar 88% të buxhetit final ose 823,917,867€, me një trend të njëjtë të me vitin 2022. Zbatimi i buxhetit nga financimi përmes huamarrjes dhe klauzoles së investimeve mbetet në një nivel të pakënaqshëm. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 5. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**


Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>1,111,170,611</b>	<b>936,037,857</b>	<b>823,917,867</b>	<b>752,789,075</b>	<b>655,901,138</b>
Pagat dhe mëditjet	86,865,258	21,369,855	21,364,773	21,503,106	21,880,737
Mallrat dhe shërbimet	16,504,154	15,380,223	9,062,167	8,269,524	7,488,151
Komunalitë	1,198,077	703,077	391,981	470,088	460,137
Subvencionet dhe transferet	904,119,262	853,262,828	788,767,186	721,195,040	619,961,989
Investimet Kapitale	102,483,860	45,321,875	4,331,759	1,351,318	6,110,124

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasur me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 65,495,403€ përmes vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%. Ndryshimet buxhetore ishin ndikuar nga fakti që 65,097,941€ ishin të buxhetuara si kontingjenca të cilat pastaj me vendime të qeverise jane ndarë në organizata tjera për mbulimin e mungesës së mjeteve buxhetore për ekzekutimin e pagave;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,123,931€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendime të Qeverisë, ku kishte zvogëlim për 1,231,559€ ndërsa përmes donacioneve kishte rritje prej 107,628€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 59%;
- Buxheti final për komunalitë krahasur me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 495,000€ përmes vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 56%;
- Buxheti final për subvencione dhe transfere krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 50,856,434€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendime të Qeverisë, ku kishte zvogëlim për 86,817,004€, ndërsa përmes huamarrjes, klauzoles për investime, fondit zhvillimor në mirëbesim dhe donacioneve kishte rritje për 35,960,570€. Krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje të buxhetit dhe shpenzimeve për kete kategori. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 92%; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 57,161,985€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendime të Qeverise kishte zvogëlim për 33,152,100€, financimi permes huamarrjes – klauzola e investimeve kishte zvogëlim prej 24,010,962€ ndërsa nga donacionet kishte rritje prej 1,077€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte vetëm 4,331,759€ apo 9.55%.

Nga Pakoja për Ringjallje Ekonomike, në kuadër të MFPT ishin shpenzuar 89,196,896€ ndërsa nga kontigjenca e BE-së në energji 39,773,036€. Këto shpenzime janë realizuar nga kategoria subvencione dhe transfere.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e planifikuara nga Qeveria e Kosovës me Ligjin nr. 08/L-193 për ndarjet buxhetore për vitin 2023 ishin 2,564,458,930€. Nga kjo vlerë Ministria e Financave Punës dhe Transfereve përfshirë (Dogana e Kosovës dhe Administrata Tatimore) kishte arritur të realizonte të hyra neto 2,466,504,812€.

Të hyrat tatimore për vitin 2023 për Doganën e Kosovës kanë qenë në vlerë prej 1,673,023,558€, ndërsa në vlera neto realizimi ishte 1,671,083,921€, (të hyrat bruto 1,673,023,558€-1,939,637 kthimet). Krahasuar me vitin 2022, këtë vit kishte rritje për 9%.

Ndërsa, Administrata Tatimore e Kosovës kishte arritur të realizonte 852,139,963€, ndërsa në vlera neto realizimi ishte 792,802,901€, (të hyrat bruto 852,139,963€ -59,337,062€ kthimet). Krahasuar me vitin e kaluar, të hyrat bruto në përgjithësi kanë pësuar rritje. Krahasuar me vitin 2022 këtë vit kishte rritje për rreth 18%.

**Tabela 6. Të hyrat (në €)**

Agjencitë / Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	Të hyrat neto 2023	Të hyrat neto 2022	Të hyrat neto 2021
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>2,527,781,511</b>	<b>-61,276,699</b>	<b>2,466,504,812</b>	<b>2,188,900,388</b>	<b>1,916,622,877</b>
Administrata tatimore e Kosovës	852,139,963	-59,337,062	792,802,901	659,261,218	541,632,809
Dogana e Kosovës	1,673,023,558	-1,939,637	1,671,083,921	1,528,853,806	1,373,862,694
Njësia e Inteligjencës Financiare	127,128	0	127,128	19,633	610,000
AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT	29,171	0	29,171	0	0
ADMINISTRATA QENDRORE - MF	59,720	0	59,720	96,588	45,462
INSPEKTORIATI I PUNËS	1,138,140	0	1,138,140	587,018	410,502
ADMINISTRATA THESARI I KOSOVËS	1,231,611	0	1,231,611	43,125	35,000
KËSHILLI I PËRGJITHSHËM I SHËRBIMEVE SOCIALE	0	0	0	3,030	4,991
SHËRBIMET E PUNËSIMIT	32,220	0	32,220	35,970	21,420


## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2022 të MFPT duke përfshi Doganen e Kosoves dhe ATK ka rezultuar në 15 rekomandime. MFPT, Dogana dhe ATK kishin përgatitur Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, katër rekomandime janë zbatuar, tre ishin në proces, pesë nuk janë zbatuar ende dhe tre nuk janë të aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikon 2.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 7 (ose Tabelën e rekomandimeve).

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 7 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Akciza	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete dhe me kohë për azhurnimin e plotë të kodeve tarifore në sistemin ASYCUDA, duke siguruar harmonizimin e plotë të tyre me TARIK.	Janë ndërmarrë veprimet e duhura dhe këtë vit nuk kemi identifikuar raste të tilla.	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj menaxhim efikas në procesin e kthimeve/rimbursimeve, në mënyrë që kërkesat për rimbursim të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar ligjor. Në rastet e vonesave nga ATK duhet të aplikohet pagesa e interesit për tatim pagesit.	Edhe kete vit kemi hasur ne raste te njejta.	Nuk ka filluar zbatimin
3.	Baza për konkluzion	Ministri përmes Sekretarit të Përgjithshëm, duhet të siguroj marrjen e veprimeve ligjore (përmbaramore) ndaj personave përgjegjës të cilët nuk i kanë arsyetuar ose kthyer mjetet e pranuar - avanset.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë masa dhe krahasuar me vitin paraprak kishte një renje prej 30,241€ kjo si pasojë e veprimeve të ndërmarra nga ana e MFPT.	Pjesërisht i zbatuar
4.	Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se të gjitha bizneset të cilat i plotësojnë kriteret për fiskalizim do të pajisen me pajisjet elektronike fiskale (PEF) sipas kërkesave ligjore.	Regjistrimet e vazhdueshme të bizneseve të reja (në fund të vitit) e pamundësojnë që të gjitha bizneset të jenë të fiskalizuara në fund të vitit përshkak të procedurave të fiskalizimit. Kryesisht mikrobizneset me qarkullim vjetor deri në 5,000€ nuk janë plotësisht të fiskalizuara.	Nuk është i aplikueshëm më
5.	Pagat dhe mëditjet	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime konkrete për plotësimin e vendeve të lira të punës sipas Strukturës Organizative, duke i dhënë rëndësi të veçantë pozitive menaxhuese në kuadër të organizatës. Po ashtu, plani për rekrutim dhe avancim të stafit duhet të përgatitet paraprakisht për vitin vijues, në mënyrë që të realizohet gjatë vitit përkatës.	Gjatë vitit 2023 Dogana ka filluar procesin e rekrutimeve dhe avancimeve.	I zbatuar
6.	Pagat dhe mëditjet	Ministri, duhet të aprovohet rregulloren e organizimit të brendshëm dhe të ndërmarrë veprimet e nevojshme	Rregullorja për organizimin e brendshëm është aprovuar. Për	Nuk është i aplikueshëm më

		lidhur me kryerjen e procesit të fuzionimit të strukturës dhe të stafit të MFPT-së, dhe sa më parë pozitat udhëheqëse me zëvendësues të plotësohen me staf të rregullt.	shkak të ndryshimeve ligjore ky rekomandim për këtë vit konsiderohet i mbyllur.	
7.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të analizojë në hollësi çështjen e pagesave më sipër dhe të shqyrtoj mundësitë për kthimin e tyre nga shfrytëzuesit në llogarinë e buxhetit. Gjithashtu duhet të siguroj forcimin e kontrolleve të brendshme në mënyrë që të krijoj një komunikim më efektiv ndërmjet databazave të skemave pensionale.	Kjo kategori e skemave pensionale krahasuar me vitin paraprak ka një progres.	Pjesërisht i zbatuar
8.	Subvencionet dhe transferet	Ministri duhet të iniciojë procedurat për të bërë interpretim dhe vlerësim të pajtueshmërisë së dispozitave ligjore në lidhje me pensionet e dyfishta.	Ne krahasim me vitin e kaluar ka rritje të vlerës për përfitues të cilët gëzojnë më shumë se një pension.	Nuk ka filluar zbatimin
9.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që shpenzimet planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit dhe që pagesa dhe regjistrimi i tyre bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate.	Edhe kete vit kemi hasur ne keqklasifikim të shpenzimeve.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Pasuritë	Ministri, duhet të siguroj se para përgatitjes së pasqyrave financiare të bëhet inventarizimi i gjithë pasurisë në kuadër të MFPT-së si dhe krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive në mënyrë që të bëhet prezantimi i saktë dhe i plotë i pasurive në PFV për vitin 2023.	Menaxhmenti nuk kishte bërë përpjekje në sigurimin e kontrolleve efektive në fushën e pasurisë pasi që kemi hasur çështje të njejta.	Nuk ka filluar zbatimin
11.	Pasuritë	Ministri duhet të vendosë kontrolle efektive në menaxhimin dhe raportimin e pasurive në PFV dhe të siguroj përmes zyrtarëve përkatës se pasuritë evidentohen, klasifikohen dhe shpalosen duke i respektuar të gjitha procedurat e kërkuara me rregulloren e aplikueshme të pasurisë.	Nuk kemi identifikuar mangësi të natyrës së njëjtë.	I zbatuar
12.	Pasuritë	Drejtori i Përgjithshëm duhet të ndërmerr veprime konkrete në kohën e duhur për angazhimin e stafit për të mbuluar pozita e lira në mënyrë që të mos shkaktohen pengesa në operim gjatë evidentimit të pasurive. Po ashtu, të funksionalizoj sistemin Inventory nën 1,000€ që të bëjë migrimin e pasurive në sistemin e-pasuria.	Nuk kemi identifikuar mangësi të natyrës së njëjtë.	I zbatuar
13.	Llogaritë e arkëtueshme	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprime më efektive në inkasimin e këtyre borxheve. Për më tepër, përpjekje shtesë nevojiten në trajtimin e stokut	Edhe këtë vit gjendja e stokut të llogarive të arkëtueshme është e njëjtë.	Pjesërisht i zbatuar

		të borxheve të vjetra bazuar në kërkesat ligjore përkatëse.		
14.	Detyrimet Kontigjente	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj për aq sa është e mundshme, të bëhet një matje dhe vlerësim financiar për detyrimet kontigjente dhe këto të prezantohen me vlerë financiare në PFV e vitit 2023.	Ky rekomandim është përfshirë në raport si një rekomandim.	Nuk është i aplikueshëm më
15.	Detyrimet Kontigjente	Ministri, duhet të siguroj një koordinim më të mirë në mes zyrës ligjore dhe asaj të financave me qëllim që regjistrat e detyrimeve kontigjente të mbahen të saktë dhe të azhurnuar me informatat e reja, në mënyrë që shënimet në PFV të prezantohen të sakta.	Edhe këtë vit kemi hasur ne mos raportim të saktë të detyrimeve kontigjente.	Nuk ka filluar zbatimin

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndhmës Auditor i Përgjithshëm



Faruk Rrahmani, Drejtor i Auditimit



Alban Beka, Udhëheqës i ekipit



Arta Kryeziu, Anëtare e ekipit



Veton Misiri, Anëtar i ekipit



Edona Abazi, Anëtare e ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANIMORISHTUAR: DATE OF RECEIPT: - 7-06-2024			
Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Prot. Br. Prot.
03	47	779	1



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive			
Nr. Prot. Br. Prot.		Nr. Prot. Br. Prot.	
01/2024		1498/2024	
Data Datum		Data Datum	
04/06/2024		04/06/2024	
PRISHTINË/A			

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers

Kabineti i Ministrimit - Kabinet Ministra - Minister's Cabinet

Prishtinë, 04.06.2024

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkresë, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të **Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve**, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Hekuran Murrati,  
Ministër i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

**(shkëputur nga SNISA 200)**

### **Forma e opinionit**

#### **Opinion i pa-modifikuar**

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

### **Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit**

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri.

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### **Opinionit i kualifikuar**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### **Opinionit i kundërt**

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit:

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.